



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo



Komuna e Prishtinës
Opština Priština - Municipality of Prishtina

KRYETARI I KRYEQYTETIT

14-020/04-122487/më 17 SEP 2024

Në mbështetje të nenit 13 të Ligjit nr. 03/L-040, për vetëqeverisje lokale ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës" nr. 28/15 qershor 2008), nenit 5 paragrafi 5.2. të Ligjit Nr. 03/L-087 për Ndërmarrjet Publike si dhe nenit 53 të Statutit të Komunës së Prishtinës, 01. nr. 110 – 391, të dt. 25.02.2010, Kryetari i Kryeqytetit të Republikës së Kosovës, Prishtinës, merr këtë:

V E N D I M

Për caktimin e anëtarit në Komisionin Komunal të Aksionarëve për NPL "Prishtina Parking" SH.A

1. Endrit Zabergja caktohet anëtar në Komisionin Komunal të Aksionarëve për NPL "Prishtina Parking" SH.A.
2. Anëtari i cekur në pikën 1 të këtij vendimi se bashku me 2 (dy) anëtarët tjerë të cilët i emëron Kuvendi i Kryeqytetit e përbëjnë Komisionin Komunal të Aksionarëve për Ndërmarrjen Publike Lokale "Prishtina Parking" SH.A.
3. Anëtari i Komisionit Komunal të Aksionarëve i caktuar me këtë Vendim, ka të drejtë të veprojë në emër të Kryetarit të Kryeqytetit.
4. Veprimet e anëtarit të Komisionit Komunal të Aksionarëve duhet të jenë në përputhje me Ligjin përkatës për Ndërmarrjet Publike dhe Ligjin përkatës për Shoqëritë Tregtare.
5. Me hyrjen në fuqi të këtij vendimi, shfuqizohet Vendimi nr. 14-020/04-30340/24 i datës 28.02.2024.
6. Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

U DORËZOHET:

- Anëtarit të emëruar z. Endrit Zabergja;
- Anëtarit të liruar nga detyra z. Bekim Gashi;
- Qendrës për shërbime me qytetarë; dhe
- Në dosje.

KRYETARI I KRYEQYTETIT
Përparim Rama

